

10.3 PARAQITËSI

Paraqitja e regjistrimeve nga lista e rezultateve të kërkimit në dritaren **Paraqitja – Regjistrimi i njësuar (SGC)** funksionon njëjtë si në paraqitësin e regjistrimeve bibliografike. Ndryshojnë vetëm për nga të dhënat që shfaqen në regjistrim. Edhe këtu, sikurse në paraqitësin e regjistrimeve bibliografike, ekzistojnë tri lloje të formateve për paraqitjen e regjistrimit.

10.3.1 Formati bazë

Shfaqja në formatin bazë mundëson paraqitjen e regjistrimit në formën e listës së attributeve.

Në formatin bazë paraqiten këto attribute dhe vlerat e tyre:

- numri identifikues (SGC.SI-ID)
- lloji i pikëqasjes së njësuar
- pikëqasja e njësuar
- pikëqasja e njësuar anglisht
- shënime për përdoruesin
- variantet e pikëqasjes
- termat e gjerë
- pikëqasjet në lidhshmëri
- LCSH
- Sears
- MeSH
- RAMEAU
- burimet
- shënimet për kataloguesit
- KDU

10.3.2 Formatu MARC

Shfaqja në formatin MARC mundëson paraqitjen e regjistrimit në formën e fushave dhe nënfushave të formatit COMARC/A (shih manualin *COMARC/A*).

Nga fusha e sistemit shfaqen këto të dhëna:

- numri identifikues i regjistrimit ("ID")
- numri lokal i regjistrimit ("LN")
- lloji i maskës
- versioni i regjistrimit
- data e krijimit të regjistrimit dhe emri i personit që e ka krijuar atë

- data e ndryshimeve të fundit në regjistrim dhe emri i personit që ka bërë ndryshimet ("Updated")
- data e verifikimit të regjistrimit dhe emrit të personit, i cili e ka verifikuar regjistrimin ("Verified")
- emri i personit, i cili duhet të kryej punën në vazhdim në procesin e redaktimit të regjistrimit ("Adopted by")
- statusi i verifikimit ("In progress" – regjistrimi në krijim, "Unverified" – regjistrimi i dërguar për verifikim, "Returned" – regjistrimi që i është kthyer propozuesit për ta përmirësuar ose plotësuar, "Rejected" – regjistrimi, i cili në bazë të parimeve SGC nuk përputhet me kushtet për përfshirje në bazën e të dhënave SGC)



Shembull:

Në paraqitësin e regjistrimeve të njësuara kontrollohet regjistrimi me ID=185960. Nga fusha e sistemit shfaqen të dhënat për regjistrimin:

**ID=185960 LN=0000000726 TN V1 02.04.2002 SGC::HUMGLA_SEARS
Updated: 21.03.2018 SGC::IZUM_BISERKA Adopted by:
SGCNV::IZUM_MATJAZZ Unverified**

Regjistrimi është krijuar në bazë të regjistrimit nga lista e emërtimeve lëndore Sears. Është redaktuar nga redaktorja me emrin e përdoruesit BISERKA. Regjistrimi duhet të verifikohet nga redaktuesi me emrin e përdoruesit MATJAZZ.

10.3.3 Formati standard

Shfaqja në formatin standard mundëson paraqitjen e regjistrimit në formën sipas modelit GSARE (*Guidelines for Subject Authority and References Entries*). Elementet e shfaqjes (nëse ekzistojnë) janë të paraqitura në këtë renditje:

- pikëqasja e njësuar
- pikëqasja e njësuar në anglisht
- shënimet nga blloku i shënimeve publike
- variantet e pikëqasjes
- termat e gjerë
- termat në lidhshmëri
- termat e ngushtë
- shënimet nga blloku i informacioneve për burimin e të dhënave
- pikëqasjet nga listat e tjera të emërtimeve lëndore
- KDU
- numri identifikues (SGC.SI-ID)
- burimi i regjistrimit
- data e krijimit
- data e ndryshimeve të fundit